

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUA

"TENESTIA" T I R A N E .

I mbajtur sot ne date 08.05.2001 ne Tirane, nga Bukurosh KOÇI I biri I Hamdiut, lindur me 1960 ne Ulze dhe banues ne Tirane, Rr."5 Maji", Vila e re, I cili vendosi:

Neni 1

Te krijoje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "TENESTIA" Tirane.

Selia e kesaj shoqerie do te jete ne Tirane, Rr."5 Maji" Vila e re.

Neni 2

Kjo shoqeri krijohet per nje afat kohe prej 20 vjetesh, me te drejte perteritje sipas deshires se ortakut te vetem.

Neni 3

Ne perputhje me Kodin Tregetar Shqiptar kjo shoqeri eshte person juridik dhe veprimtaria e saj rregullohet sipa dispozitave te ketij Kodi si dhe normave te percaktuara ne aktin e themelimit dhe Statutin e saj.

Neni 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Kjo shoqeri ka per objekt te saj ushtrimin e veprimtarise private ne keto drejtime:

- Shfrytezim I mineraleve te ndyshme ne siperfaqe dhe nentoke.
- Tregetimi I mineraleve brenda dhe jashte vendit.
- Hapja dhe ndertimi I punimeve minerare te çdo lloji ne nentoke dhe siperfaqe.
- Studimi e projektimi I vendburimeve te çdo lloji minerali te dobishem.
- Tregetimi I te gjitha llojeve te materialeve, leneve te para, makinerive e pjeseve te kembimit.
- Transport I mallrave e leneve te para brenda e jashte vendit, transport pasagjeresh.
- Ndertim, montim ne siperfaqe dhe nentoke.



Neni 5

Per zhvillimin e kesaj veprimtarie kjo shoqeri ka derdhur kapitalin prej 100.000 leke

Neni 6

Administratori i kesaj shoqerije eshte ortaku i vetem Bukurosh KOÇI.

DISPOZITA TE TJERA

Dispozita me te hollesishme per kete shoqeri, percaktohen ne statutin e saj qe i bashkengjitet ketij akti themelimi.

Ky akt themelimi pasi u lexua dhe u gjet sipas vullnetit te ortakut u firmos prej tij rregullisht.

Bukurosh KOÇI

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUA

"TENESTIA" T I R A N E .

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Kjo shoqeri eshte krijuar ne perputhje me Ligjin 7638 date 09.11.1992 "Per shoqerite tregtare " dhe eshte person juridik me vehte.
Te drejtat e personit juridik kjo shoqeri I fiton nga data e dhenjes se vendimit te Organeve gjyqsore.

Neni 2

Kjo shoqeri eshte krijuar nga ortaku I vetem, Bukurosh KOÇI, I biri I Hamdiut lindur me 1960 ne Ulze e banues ne Tirane Rr."5 Maji", Vila e re.

Neni 3

Kjo shoqeri ushtron aktivitetin e vet ne perputhje me Kodin Tregetar dhe legjislacionin shqiptar si dhe me dispozitat e paraqitura ne dokumentat e krijimit te saj si Statuti dhe aktii i themelimit.

Neni 4

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "TENESTIA" Tirane, kryen aktivitetin e saj industrial dhe tregatar ne keto drejtime :

- Shfrytezim I mineraleve te ndyshme ne siperfaqe dhe nentoke.
- Tregetimi I mineraleve brenda dhe jashte vendit.
- Hapja dhe ndertimi I punimeve minerare te çdo lloji ne nentoke dhe siperfaqe.
- Studimi e projektimi I vendburimeve te çdo lloji minerali te dobishem.
- Tregetimi I te gjitha llojeve te materialeve, lenedeve te para, makinerive e pjeseve te kembimit.
- Transport I mallrave e lenedeve te para brenda e jashte vendit, transport pasagjeresh.
- Ndertim, montim ne siperfaqe dhe nentoke.

Neni 5

Detyrimeve qe linden gjate zhvillimit te aktivitetit ortakut i vetem u pergjigjet me mjetet e veta.

Neni 6

Ortakut i vetem ka keto te drejta kryesore:

- ❖ administrimin e te gjitha aktivitetit ne perputhje me aktin e themelimit dhe statutin
- ❖ marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike dhe veprimtarine e zhvilluar

Neni 7

Ortakut i vetem ka per detyre te jape te gjitha te dhenat e domosdoshme dhe te kryeje te gjitha detyrat per realizimin e objektit te veprimtarise private.

KREU II KUSHTET EKONOMIKE

Neni 8

Aktiviteti i kesaj shoqerie zhvillohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj periodike.

Neni 9

Per te bere te mundur zhvillimin e kesaj veprimtarie vihet nje kapital baze prej 100.000 leke te reja, qe perben burimin fillestar dhe te krijimit te mjeteve te xhiros.

Ky kapital mund te shtohet apo pakesohet sipas vendimit te marre nga administratori i saj zoti Bukurosh KOÇI

Neni 10

Kur pushon aktiviteti, pasi shlyhen te gjitha detyrimet ligjore pjesa e mbetur e kapitalit dhe te ardhurat e tjera mbeten ne pronesi te ortakut te vetem

Neni 11

Ortaku i vetem gezon te drejten e mbrojtjes se pasurive te tij ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

KREU III
ADMINISTRIMI

Neni 12

Administratori i kesaj shoqerie eshte ortaku i vetem Bukurosh KOÇI

Neni 13

Kjo shoqeri ka te drejte te punesoje edhe persona te tjere duke respektuar normat e Kodit te Punes.

Neni 14

Marredheniet e punes ne Shqiperi rregullohen nepermjet kontrates individuale te punes, ku percaktohen me saktesi kushtet e saj.

KREU IV
PUSHIMI I AKTIVITETIT

Neni 15

Aktiviteti i kesaj shoqerie pushon me plotesimin e afatit prej 20 vjetesh.

Neni 16

Kjo shoqeri krijohet per nje afat kohor prej 20 vjetesh me te drejte ripertesitje me kalimin e ketij afati sipas deshires se ortakut te vetem.

Neni 17

Selia e kesaj shoqerije do te jete ne Tirane ne Rr. "5 Maji", Vila e re.

Ky statut pasi u lexua dhe u gjet ne rregull, firmoset prej ortakut te vetem

Bukurosh KOÇI

